

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 ri-shpall:

KONKURS PUBLIK

për plotësimin e vendit të punës me të dhënat si në vijim:

Titulli i pozitës:	KONTABILIST
Orari:	3-4 ditë në javë
Numri i referencës:	KON072025
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë 1 vjeçare (me mundësi vazhdimi)
Adresa:	Rr. "Perandori Justinian" Nr. 71, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës:

RAPORTET:

- Në përputhje me SNRF-të, përgatitë pasqyrat financiare vjetore për Operacionet e FKPK-së dhe për Mjetet Pensionale (në shqip, anglisht dhe serbisht).
- Përpilon pasqyrat e detajuara mujore për Pozicionin Financiar, Pasqyrën e të Ardhurave, si dhe Shpenzimet kundrejt Buxhetit për qëllim të brendshëm.
- Ndihmon në përpilimin e raporteve periodike të nevojshme për raportim elektronik (FINA) në BQK.
- Bën raportimet e nevojshme në Administratën Tatimore brenda afateve të përcaktuara.

KONTABILITETI DHE PAGESAT:

- Mirëmban planin kontabël në Librin e Përgjithshëm (LP).
- Bën regjistrimet fillestare për vitin kontabël dhe ato përmbyllëse për muajin / vitin.
- Përgatit lejin e brendshëm për pagesat bashkë me regjistrimet kontabël të Operacioneve, me dokumentacionin burimor të mjaftueshëm dhe autorizimet në përputhje me politikat e brendshme.
- Regjiston në LP transaksionet e llogarive bankare të Operacioneve dhe siguron harmonizimin me gjendjet përkatëse.
- Në baza mujore harmonizon gjendjen e Fondeve Pensionale në sistemin administrativ me atë në LP.

POLITIKAT DHE PROCEDURAT:

- Informon mbi ndryshimet në legjislacionin tatimor, SNRF-të dhe rregullat e opinionet tjera me ndikim në politikat financiare dhe kontabël të FKPK-së.
- Rekomandon ndryshime në politikat dhe procedurat kontabël dhe ato financiare; siguron veprim në përputhshmëri të plotë me të njëjtat.

MJETET PENSIONALE DHE TË TJERA:

- Në mungesë të zyrtarit financiar, kryen punët që ndërlihen me vlerësimin ditor të Fondeve Pensionale në sistemin administrativ të kursimeve pensionale.
- Kryen detyra të tjera që mund t'i caktohen nga Drejtori Menaxhues, Drejtori për Financa, apo Bordi Drejtues, si dhe ato të përcaktuara në procedurat dhe politikat e brendshme të FKPK-së.

Kriteret e konkursit:

Edukimi:	Bachelor në financa, kontabilitet ose ngjashëm (të diplomuarit jashtë Kosovës duhet ta kenë diplomën e nostrifikuar).
Certifikimi:	Së paku "Teknik i kontabilitetit"
Përvoja:	Së paku pesë (5) vjet përvoja pune në kontabilitet / financa.

Afati dhe mënyra e konkurimit:

- Afati për konkurrim është i hapur prej **27 tetor 2025** e deri **më 11 nëntor 2025, ora 16:00**.
- Aplikimi për këtë pozitë bëhet duke dërguar email me temë "KON072025" në adresën: **recruitment@trusti.org**, dhe duke bashkangjitur dokumentet në vijim (në shqip, anglisht ose serbisht):
 - Biografinë (CV);
 - Letrën motivuese;
 - Referencat apo dokumente të tjera që e dëshmojnë përvojën e kërkuar në lëmin përkatës;
 - Kopjet e certifikatave profesionale dhe diplomave universitare e post-universitare të deklaruara në CV;
 - Certifikata e historisë penale.

Shënim:

- Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit do të shqyrtohen dhe kontaktohen për më tutje.

- Përvoja e punës në kontabilitet / financa të fondeve pensionale si dhe nivelet e certifikimet profesionale të kontabilitetit (ACCA, SHKÇAK, IKA, IAAB ose ngjashëm) poentohet më shumë.

- Kandidatët mund t'i nënshtrohen testimit për vlerësimin e aftësive të kërkuara.

FKPK-ja është punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!